



REPUBLIC OF KOSOVO		REPUBLIKA E KOSOVËS	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE			
ANTI - CORRUPTION AGENCY			
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-2503/14
Dok.		Prot. No.	
Nr. Prot.		Dat.	04-07-2014
Br. sh. flet.	02	Datum	
Nr. flet.		Date	
Shtime			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-1771/14, për z. Bajram Hasani, Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Bajram Hasani, Anëtar i Kuvendit Komunal në Gjilan, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në biznesin privat Sh.P.K "City Projects", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Hasani është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Hasani ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për Të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Hasani ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 2463/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga bashkëpronësia.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

